



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA EKONOMIKE

PROJEKT - VENDIM

NR 5, DATË 23.01.2026

PËR

“PËR MIRATIM FONDESH SHTESE NË BUXHETIN E BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2026”

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore“, neni 54 pika dh , te ligjit 68/2017 “Per financat e veteqeverisjen vendore“ neni 46 , të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH” i ndryshuar neni 47 , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomis nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të VKB nr. 71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2026”, shkresës së Ministrisë së Financave me nr.18133/1 prot., datë 24.12.2025 ,si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit,Mjedisit dhe Prones dhe nga Drejtoria e Shërbimit Social;

-Ju paraqesim për diskutim e miratim

I. Të miratohet fondi shtese i akorduar për bashkinë Roskovec prej **37,625,541** leke si transfert e pakushtëzuar e përgjithshme dhe akordim nga fondi rezervë për njësit e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025,për shlyerje detyrimesh të prabambetura sipas përcaktimeve në aktin normative dhe në shkresën përkatëse.

Shtohet:

1. NJESIA SHPENZUESE "BASHKIA ROSKOVEC", KODI 2113001

•	Gr.00	TIT. 01110	KAP. 01	ART. 602	14,073,775	lekë
•	Gr.00	TIT. 09120	KAP. 01	ART. 602	2,479,174	lekë
•	Gr.00	TIT. 08220	KAP. 01	ART. 602	97,200	lekë
•	Gr.00	TIT. 10430	KAP. 01	ART. 602	976,392	lekë
•	Gr.00	TIT. 04520	KAP. 01	ART. 231	20,000,000	lekë

TOTAL 37,625,541 lekë

II. Të miratohet fondi shtese i akorduar për bashkinë Roskovec prej **1,023,000** lekë nga Fondi Social për vitin 2026:

Shtohet:

2. NJESIA SHPENZUESE "BASHKIA ROSKOVEC", KODI 2113001

-	Gr.13	TIT. 10430	KAP. 01	ART. 606	1,023,000	leke
---	-------	------------	---------	----------	-----------	------

III. Të miratojë alokimin e fondeve të përfituara nga Granti i Bazuar në Performancë (GBP) për Bashkinë Roskovec për vitin 2025, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit, sipas vendimit përfundimtarë të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve, në vlerën totale **5,828,911.82** lekë, për "Restaurimi i shkollës në fshatin Arapaj" me qëllim përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe sigurisë së nxënësve. Vlera e plotë e projektit është **9,828,912 lekë me TVSH**, nga e cila 40.69% financohet nga Bashkia Roskovec konkretisht **4,000,000 lekë** e miratuar me VKB nr. 71 datë 24.12.2025 "Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2026" dhe 59.3% do të financohet nga Buxheti i Shtetit me vlerë **5,828,911.82 lekë**.
Fondet e miratuara sipas pikes **3** të këtij vendimi të reflektohen në buxhetin e Bashkisë për vitin 2026, në programet përkatës si më poshtë.

Shtohet:

3. NJËSIA SHPENZUESE "BASHKIA ROSKOVEC", KODI 2113001

- Gr.00 TIT. 09120 KAP. 01 ART. 231 **5,828,911.82 lekë**

IV. Ngarkohet struktura përgjegjëse e Administratës së Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

Konceptoi : *O. Goga*

Konfirmoi: *D. Hoxha*

Per Drejtorine Juridike dhe te Burimeve Njerezore : *V. Zeqo*

KRYETAR
Majlinda BUFI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 452/1 prot

Roskovec , më 23.01 .2026

RELACION

PËR

“PËR MIRATIM FONDESH SHITESË NË BUXHETIN E BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2026”

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore“, neni 54 pika dh , te ligjit 68/2017 “Per financat e veteqeverisjen vendore“ neni 46 , të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH”, i ndryshuar ,neni 47, të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Aktit Normativ nr.11 date 19.12.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të shkresës së MFE nr.18059/15 prot., datë 24.12.2025, ju relatojmë se bashkisë Roskovec i është miratuar fondi prej **17,625,541** si transfert e pakushtëzuar e përgjithshme për shlyerje detyrimesh të prapambetura sipas përcaktimeve në aktin e mësipërm për shlyerjen e faturave me të vjetra dhe nw bazw tw shkresws nr.17946/1 prot., datë 24.12.2025, bashkisë Roskovec i është miratuar fondi prej **20,000,000** “Akordim nga fondi rezervë për njësit e vetëqeverisjes vendore, për vitin 2025”, për shlyerjen e faturave me të vjetra. Këto fatura janë të deklaruar në sistemin e thesarit si detyrime të prapambetura e për pasojë do të jenë faturat që do shlyhen me fondin e akorduar si më sipër.

Duke patur parasysh që në bazë të dhënave të thesarit këto fatura i përkasin detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik, kemi përcaktuar në projekt-vendimin që u paraqesim që fondi prej **20,000,000** të përdoret në programin 04520 “Rrjeti Rrugor Rural”, ndërsa fondi prej **17,625,541** të përdoret për të likuajduar faturat e llogarisë ekonomike 602, gjë e cila do të lehtësojë financat e bashkisë nga këto detyrime.

DREJTOR EKONOMIK

Orgesa Goga

KRYETAR

Majlinda Bufi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. 452/2 prot.

Roskovec, më 23 . 01 .2026

Lënda: Relacion mbi miratimin e Fondit Social 2026 për vijimin e ofrimit të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuarit tek “Kafja e gjyshit”

KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu!

Të nderuar Këshilltarë të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Roskovec,

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 8 pika 5, nenit 15 pika 3 dhe nenit 23 të ligjit nr. 121/2016, datë 21.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Vendimit nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, ju paraqesim këtë relacion informues lidhur me vijimin e shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuarit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe në funksion të garantimit të vazhdimësisë së shërbimeve sociale të ngritura në kuadër të Fondit Social, ka njoftuar se Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave për Financimin e Ofrimit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror ka miratuar vijimin e mbështetjes financiare për vitin e pestë të ofrimit të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuarit “Tek Kafeja e gjyshit”, në Bashkinë Roskovec, për vitin 2026.

Në kuadër të Fondit Social 2026, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të financojë deri në 30% të kostos totale të shërbimit, në vlerën **1,023,000 (një milion e njëzet e tre mijë) lekë** për vitin 2026.

Target-grupi përfitues i shërbimit përfshin:

1. 25 Pensionistë të vetmuar;

Ashtu siç është zbatuar edhe gjatë periudhës 2023–2025, përfituesve të programit do t'u ofrohet shërbimi i vaktit ushqimor të drekës në formë katering, nga e hëna deri të premten, me menu të larmishme dhe të përshtatura sipas nevojave ushqimore, duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetesës, mirëqenies sociale dhe reduktimin e izolimit social të të moshuarve.

Vijimi i këtij shërbimi konsiderohet me rëndësi të veçantë sociale, pasi kontribuon drejtpërdrejt në mbështetjen e shtresave në nevojë, forcimin e përfshirjes sociale dhe garantimin e dinjitetit për moshën e tretë.

Duke shpresuar në mirëkuptimin Tuaj!

Konceptoi : Xh.Plaka

Miratoi : S.Cepele

Konfirmoi: M.Goga

Sasia e ekzemplarëve të shtypur : 3(tre)!


KRYETAR
Majlinda-Bufi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT, MJEDISIT
DHE PRONËS

Nr. 452/3 prot

Roskovec, më 23.01.2026

RELACION

Lënda : Mbi “Restaurimin e shkollës fshati Arapaj”, i cili do të financohet nga **Granti I Performancës**, në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës arsimore dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve publike vendore”.

Të nderuar këshilltarë/e

Shkolla 9-vjeçare “Rrahmen Dashi” Arapaj, e vendosur në Njësinë Administrative Strum, Bashkia Roskovec, është një institucion arsimor publik që shërben për edukimin bazë të nxënësve të zonës. Godina e shkollës është ndërtuar prej vitesh dhe aktualisht paraqet problematika të evidentuara infrastrukturore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e procesit mësimor dhe në sigurinë e nxënësve dhe stafit pedagogjik.

Amortizimi i elementeve konstruktive dhe jo-konstruktive, kushtet jo optimale të ambienteve mësimore, si dhe nevoja për përmirësim të kushteve higjieno-sanitare dhe funksionale, e bëjnë të domosdoshme ndërhyrjen për rehabilitimin dhe përmirësimin e godinës shkollore.

Investimi i propozuar synon përmirësimin e kushteve fizike dhe funksionale të Shkollës 9-vjeçare “Arapaj”, duke garantuar një mjedis të sigurt, të përshtatshëm dhe dinjitoz për zhvillimin e procesit mësimor-edukativ.

Projekti do të financohet nga **Granti i Performancës**, në kuadër të përdorimit të fondeve të alokuara për bashkitë që kanë përmbushur kriteret e performancës në menaxhimin financiar dhe administrativ. Ky financim nuk krijon barrë shtesë mbi buxhetin e Bashkisë Roskovec dhe siguron përdorim efikas të fondeve publike për investime me ndikim të drejtpërdrejtë social.

Vlera e plotë e projektit është: 9 828 912.00 lekë me TVSH, nga e cila 40.69% financohet nga Bashkia Roskovec konkretisht 4 000 000 lekë dhe 59.3% do të financohet nga granti I performancës me vlerë 5 828 911.82 lekë.

Ndërhyrja është e nevojshme për:

- garantimin e sigurisë së nxënësve dhe stafit arsimor;
- përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- krijimin e një mjedisi shkollor në përputhje me standardet bashkëkohore të arsimit bazë;
- parandalimin e degradimit të mëtejshëm të godinës dhe rritjen e jetëgjatësisë së saj.
- Rehabilitimi i ambienteve të brendshme dhe të jashtme të shkollës;
- Përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare dhe funksionale;
- Rritja e sigurisë strukturore dhe funksionale të godinës;
- Krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin normal të procesit mësimor.

Përshkrimi i përgjithshëm i projektit

Projekti parashikon ndërhyrje rehabilituese dhe përmirësuese në godinën e Shkollës 9-vjeçare “Rahmen Dashi”, Arapaj të cilat përfshijnë punime ndërtimore, sistemime funksionale dhe përmirësime infrastrukturore, me qëllim krijimin e një mjedisi të sigurt dhe funksional për nxënësit dhe stafin pedagogjik.

Ndërhyrjet do të realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet teknike për objektet arsimore, duke garantuar përdorim efikas dhe afatgjatë të investimit.

Saktësisht do të ndërhryet në :

- Punime hidroizolimi, termoizolimi dhe çatie
- Punime rifinitura dhe shtresa brenda objektit
- Punime hidraulike
- Punime ne ambjente te jashtme
- Punime elektrike
- Punime dyer/dritare dhe punime bojatisje

Përputhja me politikat dhe strategjitë

Ky projekt është në përputhje me:

- Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar;
- Prioritetet e Qeverisë për përmirësimin e infrastrukturës arsimore;
- Objektivat e Bashkisë Roskovec për zhvillimin social dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike.
- Realizim I projekteve prioritare për vitin 2025-2026

Ndikimi social

Zbatimi i projektit do të përmirësojë ndjeshëm kushtet e arsimit për nxënësit e zonës, do të rrisë motivimin dhe pjesëmarrjen në procesin mësimor, si dhe do të ndikojë pozitivisht në mirëqenien e komunitetit.

Ndikimi mjedisor

Projekti nuk parashikon ndikime negative në mjedis. Përkundrazi, përmirësimi i godinës dhe kushteve të saj kontribuon në përdorim më efikas të energjisë dhe në krijimin e një mjedisi më të shëndetshëm shkollor.

Investimi në Shkollën 9-vjeçare “Arapaj” është një domosdoshmëri për garantimin e arsimit cilësor dhe të sigurt për nxënësit e zonës. Projekti përfaqëson një ndërhyrje të rëndësishme sociale dhe arsimore, me ndikim afatgjatë në zhvillimin e komunitetit dhe në përmirësimin e shërbimit arsimor publik.

Foto të gjendjes aktuale:





Duke marrë në konsideratë rëndësinë e investimit për arsimin publik, përmirësimin e kushteve të sigurisë dhe cilësisë së shërbimit arsimor, si dhe faktin që projekti financohet nga **Granti i Performancës**, propozohet miratimi i projektit “Rehabilitimi i Shkollës 9-vjeçare Arapaj” nga Këshilli Bashkiak Roskovec.

Konceptoi : *E.Hoxha*

Konfirmoi: *D.Hoxha*

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3 (tre)

KRYETAR
Majlinda Buçi